



Planuar / Doretuar Punëhet/Prodator Received/Deliverty	15.03.2022	2	viti god year
Organi/Institucioni Organ/Institution	Nr. Prot./ Pr. No.	Shtesa/ Prilog/ Appendix	Sasia/ Kolicina/ Quantity
SKOMBHEK	1399/2022		119

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.103/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bektashi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesionale në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.103/2022 të datës 09.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adres , kundër vendimit me numër KA.nr.02/2022 të datës 24.01.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.103/2022 e datës 09.02.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.02/2022 i datës 24.01.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 04.11.2021 ka shpallur konkursin për vendin e punës “Asistent për Shërbime të Sigurisë” në Prokurorinë Themelore në Prizren një (1) pozitë, me numër të referencës KPK/ZKPSH/SKPK/PSRK/PTH/POZ-020, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi . Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 17.12.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit me datë 28.12.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës merr vendimin me numër KA.Nr.02/2022 të datës 24.01.2022 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe mbetet në fuqi njoftimi i datës 17.12.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër KA.Nr.02/2022 të datës 24.01.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 07.02.2022 nëpërmjet Postës së Kosovës parashtron ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 09.02.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 16.02.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Këshilli më datë 25.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 09.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 24.01.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Konkursi i datës 04.11.2021; Vazhdimi i konkursit i datës 20.11.2021; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Vendimi i datës 01.12.2021 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Njoftimi i datës 03.12.2021 për përzgjedhjen e kandidatëve për listën e ngushtë; Deklarata për mosekzistimin e konfliktit interesit e datës 10.12.2021 e ankuesit [redacted] Testi me shkrim; Formulari për përmbledhjen e vlerësimeve individuale e datës 15.12.2021; Vlerësimi individual i kandidatëve Form. MAP-SHCK-089a i datës 15.12.2021; Aplikacioni për punësim i kandidatit [redacted] me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni për punësim i kandidatit [redacted] me dokumentacionin e bashkangjitur; Njoftimi i datës 17.12.2021 për përzgjedhjen e kandidatit; Ankesa e ankuesit e datës 28.12.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankueses i cili ka pretenduar se ka pas shkelje procedurale për procesin e rekrutimit për vendin e punës “Asistent për Shërbime të Sigurisë” në Prokurorinë Themelore në Prizren një (1) pozitë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit nuk qëndron, pasi që sipas konkursit të datës 04.11.2021 kriteret kualifikuese për vendin e punës “Asistent për Shërbime të Sigurisë” në Prokurorinë Themelore në Prizren një (1) pozitë, kanë qenë:

- Shkolla e Mesme dhe
- 3 vite përvojë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave dëshmime për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitur në dosjen e kandidatit të përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, poentimini e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në bazë të nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë që paragrafi 1 i këtij neni përcakton se: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se kandidati i përzgjedhura e ka përvojën e punës të kërkuar në pajtim me kriteret e konkursit të datës 04.11.2021 siç është kërkuar *Shkolla e Mesme dhe 3 vite përvojë*



pune, sepse kandidati i përzgjedhur në vendin e punës “Asistent për Shërbime të Sigurisë” në Prokurorinë Themelore në Prizren një (1) pozitë: [redacted] e Posedon Diplomën të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë “Ruzhdi Berisha” me të cilin dëshmohet se ka diplomuar në vitin 2012 si dhe me përvojë pune si ne vijim : Vërtetimit të lëshuar nga Drejtori i Kompanisë “NSP „Malsori”, me të cilin vërtetohet se [redacted] ka punuar në vendin e punës “Punëtor i Sigurimit Fizik” nga data 04.05.2014 gjer më 04.06.2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka pretenduar se kandidati i përzgjedhur [redacted] ka konflikt interesi sepse sipas tij supozohet se kandidati i përzgjedhure e ka pas të punësuar në këtë vend pune të atin konkretisht në Prokurorinë Themelore në Prizren, andaj lidhur me këtë pretendim Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se për raste të tilla duhet të ketë një vendim me shkrim nga organet kompetente të cilat bëjnë interpretimin e konflikt interetit.

Kolegji i Këshillit për shqyrtimin e ankesave, nga provat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga organi i punësimit ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur [redacted] nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 62.1 pikë, andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”**, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”** dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket të drejtave të veçanta të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe që është përgjegjësi e shtetit që të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur komunitetin jo shumicë ndaj veprimeve diskriminuese, Kolegji ka konstatuar se pretendimi i tillë ankimor i ankuesit nuk është i bazuar sepse organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit të jashtëm me datë 04.11.2021 ka ofruar mundësi të barabarta për të gjithë shtetasit e Kosovës, pa dallim gjinie dhe ka mirëpritur të gjitha aplikacionet e kandidatëve nga të gjitha komunitetet jo shumicë andaj Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se: **“2. Komuniteti dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil në organet e administratës publike dhe qendrore dhe lokale; 3. Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimumi 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilat u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që i përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin proporcional të komuniteteve të komunës së dhënë”** rrjedhimisht për plotësimin e këtij neni Rregullorja Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil në nenin 22 paragrafit 3 ka përcaktuar se: **“Nëse pas ditës së fundit për pranimin e aplikacioneve nuk është arritur pranimi i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik dhe gjinor, afati për pranimin e aplikacioneve zgjatet për shtatë (7) ditë kalendarike dhe publikohet nga Njësia e Personelit”** andaj me rastin konkret organi i punësimit e ka vazhduar konkursin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike në pajtim me dispozitat e lartcekura të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .




Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.02/2022 të datës 24.01.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Arkivit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.103/2022**

**Valentina Kaçandolli Bekteshi**



**Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**



**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit* [redacted]
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit Prokurorial të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Këshillin Prokurorial të Kosovës;*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*

